REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Konferenca e Kryetarëve

VENDIM
Nr. 11, datë 27.03.2020

PËR MIRATIMIN ME MIRËKUPTIM TË KALENDARIT TRE JAVOR TË PUNIMEVE TË KUVENDIT PËR PERIUDHËN 30 MARS DERI 17 PRILL 2020 DHE GRAFIKUT TË SHQYRTIMIT TË AKTEVE NORMATIVE ME FUQINË E LIGJIT NË KOMISIONET E PËRHERSHME PARLAMENTARE ME MJETIN E KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK CISCO WEBEX

Në mbështetje të nenit 12, pika 1 dhe nenit 27, pika 3 të Rregullores, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

I. Miratohet me mirëkuptim kalendari i punimeve të Kuvendit për periudhën 30 mars deri 17 prill 2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Miratohet me mirëkuptim grafiku i shqyrtimit të akteve normative me fuqinë e ligjit në komisionet e përhershme parlamentare me mjetin e komunikimit elektronik Cisco Webex.

III. Kalendari i punimeve, grafiku i shqyrtimit të akteve normative me fuqinë e ligjit si dhe çdo dokument tjetër tu dërgohet deputetëve në postën elektronike të Kuvendit.

IV. Data e mbledhjes së Kuvendit në seancë plenare do të njoftohet në një moment të dytë.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Gramoz RUÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI